



**REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA SHTIME/ OPSTINA-STIMLJE/ MUNICIPALITY OF SHTIME
ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PREDSEDNIKA/MAYOR'S OFFICE**

Nr. i Protokollit: 02/562

Procesverbal nga dëgjimi publik me banorët e fshatit Davidovc

E enjte, më 15 qershor 2023

Kohëzgjatja e takimit: 19:20 –20:15

Vendi i takimit: SHMFU “Emin Duraku”

Të pranishëm ishin: Kryesuesi i Kuvendit - Adnan Ademi; Drejtori i Drejtorisë për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini; Drejtoresha e Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, Alba Fazliu; Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik - Kastriot Shabani dhe Drejtori i Shërbimeve Publike, Bardhyl Rushiti.

Rendi i ditës:

1.Korniza Afatmesme Buxhetore 2024-2026

Këtë takim e hapi Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Shtimes, z. Adnan Ademi, i cili ka përshëndetur të pranishmit duke cekur se ky takim është i rëndësisë së veçantë, pasi që do të flitet për Draft-Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2024-2026. Më tutje z. Ademi tregoi se ne sot jemi prezent në fshatin Davidovc për të dëgjuar kërkesat e banorëve dhe ato kërkesa të vendosen në buxhetin e vitiit 2024. Ai më tutje elaboroi se si është i ndarë buxheti i Republikës së Kosovës, duke cekur se në bazë të numrit të banorëve bëhet kjo ndarje, prandaj edhe në Komunën tonë vlen e njëjta ndarje.

Në vitin paraprak 2023, kemi bërë një dëgjim publik me banorët dhe ju keni qenë së bashku me banorët e Muzeqinës, por këtë vit kemi vendosur që të mbajmë dëgjime publike në secilin fshat veç e veç, pasi që në këtë mënyrë mendojmë që dëgjimet do të janë më efektive, tha Kryesuesi Ademi. Kërkesat të cilat do t'i marrim ne janë kryesisht tek investimet kapitale siç janë: ndriqimi, kanalizimi, trotuari dhe asfaltimi, por jo vetëm, pasi që së bashku me ju do të vendosim cilat janë prioritete e juaja si fshat. Pas përfundimit të fjalimit Kryesuesi i Kuvendit për sqarime shtesë ia kaloi fjalën Drejtorit për Planifikim Urban, Kadastër dhe Gjeodezi - Grejtalb Emini.

Drejtori Emini edhe njëherë përshëndeti të pranishmit dhe i falenderoi që kanë gjetur kohë që sot të janë me ne në këtë takim, takim që është organizuar për hartimin e buxhetit për vitin 2024 dhe që u përgjigjet nevojave të qytetarëve. Ai tha se sot jam në rolin e Drejtorit por njëkohësisht jam edhe banor i fshatit Davidovc, duke cekur se është i lumtur që së bashku me banorët do të vendosin për investimet kapitale për vitin 2024. Më tutje Drejtori e ceku se në qeverisjen paraprake për fshatin Davidovc kanë qenë të ndara vetëm 25.000 euro, ndërsa nga momenti që ne e kemi marrë qeverisjen ky buxhet është

rritur në 60.000 euro për investime kapitale dhe më tutje synohet të kalojë 75.000 euro në vitin 2024. Më tutje, Drejtori elaboroi investimet të cilat janë bërë deri tani dhe të cilat do të bëhen brenda këti viti.

Kërkesat e banorëve të fshatit Davidove:


- **Lutfi Zeqiri:** Të rregullohet një segment në rrugën ‘Ibrahim Rugova’
- **Drilon Aziz:** Të rregullohet kanalizimi në rrugën ‘Smajl Gorani’, afër rrugës ‘Azizi’
- **Ilmi Sadriu:** Të rregullohet trotuari nga rruga ‘Smajl Gorani’, deri te rruga ‘Demokracia’, dhe të bëhet hapja e kanaleve atmosferike
- **Isuf Ajeti:** Tek rruga kryesore të këtë një pengesë ose shenjë rrezikshmërie për femijët në shkollë
- **Amir Shabani:** Probleme me ndriqim dhe kanalizim, vazhdimin e rrugës ‘Imer Syla’ me asfalt deri në Rashincë si dhe rregullimin e trotuarit 400 metra
- **Milazim Emini:** Të rregullohet rruga tek lagjia ‘Emini’
- **Bunjamin Emini:** Tek Xhamia të zgjerohet parkingu (me një parcelë e cila është pronë e Xhamisë)
- **Elmi Baftiu:** Kërkesë tek KEDS për shtyllat elektrike (dritat), të ndërrohen apo rregullohen, por primare të jetë kanalizimi në fshat



Procesmbajtës
Gentiana Mehmeti



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA-SHTIME/OPŠTINA-ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Lista e pjesëmarrësve ne mbledhjen e ~~Borrit te Drejtoreve~~
Date: 16.06.2023

Nr	Emri dhe Mbiemri	Ishabit	Nenshkrimi
1	Huni Sadikci		Muni Sadicë
2	Naim Brqfieri		Brahni
3	Arbona Bonelli		Arben
4	ABDNER ISLAMI		Abderr
5	Andi ISLAMI		Andi
6	Angjent Shabani		Angjent
7	Albion Shabani		Albion
8	AFRIM nurica		Afir
9	ELTON ISLAMI		Elton
10	Drlon Azimi		Drlon
11	Bardh Emimi		Bardh
12	Milazin Emipi		Milazin
13	Hjazi Sadriu		Hjazi
14	Bungamin Emimi		Bungamin
15	Amir Emimi		Amir
16	Festim Fazliu		Festim
17	Semalin Sadiku		Semalin
18	Amir Shalani		Amir
19	BASAKIM ISLAMI		Basakim